



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1620/ 9 prot.

Datë 31.07.2026

V E N D I M
Nr. 894 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Donika Daci	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.835/2026, datë 19.06.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-86131-05-19-2026, me objekt: “Blerje bojra për printer dhe fotokopje” me fond limit 6,250,000. lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 01.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues: Operatori ekonomik “Marketing&Distribution” ShPK, me Nipt J72124001N, dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 10, Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK, me Nipt. J62426002Q
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Kashar, Tiranë.

.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kamëz.
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492, Kamëz, Tiranë.

.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Me Vendimin Nr.835/2026, datë 19.06.2026 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-86131-05-19-2026, me objekt: “Blerje bojra per printer dhe fotokopje” me fond limit 6,250,000. lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 01.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
3. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.*
4. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
5. *Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me vendimet e KSHA-së si edhe me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
6. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, dhe të hartojë shtojcën me modifikimet përkatëse dhe të gjitha sqarimet e kërkuar sipas konstatimeve të këtij vendimi.*
7. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK.*
8. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.*
9. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit*
10. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

I.2. Me shkresën ardhur me nr. 6948 prot., datë 23.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1620/6 prot., datë 26.06.2026, autoriteti kontraktor informon se ka zbatuar vendimin Nr.835/2026, datë 19.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën ardhur me nr. 6948 prot., datë 23.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1620/6 prot., datë 26.06.2026, autoriteti kontraktor informon, se ka zbatuar vendimin Nr.835/2026, datë 19.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar Referuar shkresës së mësipërme, autoriteti kontraktor ka përcjellë dokumente mbi modifikime të procedurës së prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik kreu verifikime në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe konstatoi se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën përkatëse për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, në zbatim të vendimeve të KSHA-së dhe të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz ka zbatuar vendimin Nr. 835/2026, datë 19.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me REF-86131-05-19-2026, me objekt: “Blerje bojra për printer dhe fotokopje” me fond limit 6,250,000. lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar në datën 01.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Kryetar
Ismail Shehu